



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIU DHËN
01.01.2022 DERI 30.06.2022, BASHKIA BELSH”**

Tiranë 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”



PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE	4
I/1. Hyrje	4
I/2. Objekti i Auditimit	5
I/3. Qëllimi i Auditimit.....	5
I/4. Metodologjia e Auditimit	5
I/5. Konkluzioni.....	5
II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË BELSH	6
III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:	23



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

I. PËRMBLEDHJE

Në zbatim të Programit të Auditimit Tematik nr. 370 datë 18.04.2023 “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm dërguar në Bashkinë Belsh” me shkresën nr. 1022/6 prot., datë 31.01.2023, mbërritur në Bashkinë Belsh dhe regjistruar me nr. 371 prot., datë 02.02.2023, u konsiderua i nevojshëm zhvillimi në ambientet e Bashkisë Belsh, i verifikimit dhe përpilimi i një akti nga audituesit e KLSH-së Znj. S.J. dhe Znj. E.K. në cilësinë e përgjegjësit të Grupit të Auditimit, në prezencë të përfaqësueses së subjektit të auditimit Z. M.Ç. me detyrë Sekretare e Përgjithshme e Bashkisë Belsh.

I/1. Hyrje

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, me qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna: statusin e zbatimit të rekomandimeve, afateve dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre, koherencën e tyre dhe përgjegjshmërinë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

Nga verifikimi rezultoi që:

Auditimi u krye në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 370 Prot, datë 18.04.2023, me objekt: “*Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022*” në Bashkinë Belsh“.

Auditimi u krye nga:

1. E.K. përgjegjës grupi
2. S.J. anëtar

Auditimi filloi më 18.04.2023

Auditimi përfundoi më datë 26.05.2023.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacionit që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”; Vendimit nr. 63 datë 20.06.2020 “Rregullore e procedurave të Auditimit”; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 43, pika 1,3.

Nga auditimi tematik i ushtruar në Bashkinë Belsh nr. 370 Prot, datë 18.04.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Belsh” dërguar me shkresën nr. 1022/6 prot., datë 31.01.2023, u konstatua se:

- Për auditimin e mëparshëm evaduar në periudhën 01.01.2022 - 30.06.2022, raporti përfundimtar i auditimit është dërguar në Bashkinë Belsh me shkresën nr. 1000/18 datë 24.03.2022, ka mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Belsh me nr. 915 prot., datë 28.03.2022; ka hartuar planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 1149 prot., datë 15.04.2022; - Për auditimin e fundit Raporti Përfundimtar i Auditimit është dërguar me shkresën nr.1022/6 prot., datë 31.01.2023, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Belsh me nr. 371 prot., datë 02.02.2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

I/2. Objekti i Auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi i Auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e Auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësisë dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni

Tabela përmbledhëse¹

Rekomandime	Pranuar	Pjesërisht	Papranuar	Zbatuar	Pazbatuar	Shpërblim demi/eliminim efektsh	Pjesërisht/Proces Zbatimi	Realizimi %
38	38	0	0	1	4	7	24/9	2.6

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi nuk është lënë masë;
- b. Masa Organizative janë lënë 7, dhe janë pranuar 7 masa: 1 masë është zbatuar plotësisht, 6 pjesërisht, 0 masa në proces, 0 masa janë pa zbatuar;
Nga zbatimi i rekomandimeve të lëna në RPA nga auditimi i mëparshëm, janë lënë 22 masa, dhe janë pranuar 22 të cilat nga verifikimi rezultuan: 0 masa janë zbatuar, 8 masa pjesërisht dhe 9 masa në proces dhe 5 masa pa zbatuar; këto masa u rikërkuan për zbatim në RPA nga grupi i fundit i auditimit të KLSH-së;

¹ Në tabelë janë përfshirë edhe rekomandimet e lëna nga grupet e mëparshme të auditimit dhe të verifikuara mbi statusin e zbatimit të tyre dhe rikërkuar në RPA nr. 1022/6 datë 21.01.2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Në total janë 29 masa, pranuar 29 masa nga të cilat: 1 masë zbatuar; 14 masa pjesërisht zbatuar dhe 9 masa në proces; 5 masa pa zbatuar.

- c. *Me efekte negative të konstatuara* në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë lënë 3 masa, të cilat janë pranuar: 0 masa zbatuar, 3 masa pjesërisht zbatuar; 0 masa pa zbatuar; konkretisht: 1 masë në vlerën 27,163,823 lekë (diferencë) nga taksa e tokës bujqësore, 1 masë - 7,903,426 lekë për 148 subjekte nga taksa biznesi, 5,292,983 lekë për 1581 familje nga taksa e tokës bujqësore, e ndërtesës, truallit, tarifa të ndryshme vendore, në vlerën 64,489,485 lekë për 2850 familje nga toka bujqësore, në vlerën 2,128,184 lekë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për 104 subjekte, 1 masë në vlerën 7,400,000 lekë nga tarifa e lejeve të tregtimit të karburanteve;

Në total janë lënë 3 masa, pranuar 3 masa në vlerën 114,377,901 lekë, 0 masa janë zbatuar dhe pazbatuar, 3 masa pjesërisht zbatuar në vlerën 101,930,303 lekë;

- d. *Për shpërblim dëmi* nuk është lënë masë; ndërsa nga zbatimi i rekomandimeve të auditimit të mëparshëm janë lënë 4 masa në vlerën totale 1,249,341 lekë të cilat nga verifikimi kanë rezultuar pjesërisht zbatuar (në proces) dhe janë rikërkuar;

- e. *Masa për eliminimin e të ardhurave të munguara nga subjektet* lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore me efekte në të ardhurat e munguara në bashkinë Belsh nuk është lënë masë;

nga Zbatimi i rekomandimeve të lëna në RPA nga auditimi i mëparshëm janë lënë 1 masë në vlerën 1,753,576 lekë, pranuar 1 masë, të cilat nga verifikimi kanë rezultuar pjesërisht zbatuar si dhe është rikërkuar në vlerë të plotë;

- f. *Masa disiplinore* për dy kategori:

- C/1 masa për punonjës me statusin e nëpunësit civil janë lënë për 7 punonjës;
- C/2 masa për punonjës me Kod Pune është lënë për 1 punonjës.

Masat janë pjesërisht zbatuar dhe në proces.

Pra nga verifikimet e bëra mbi shkallën e zbatueshmërisë së rekomandimeve të lëna nga auditimi mëparshëm i KLSH, rezulton se nga 38 rekomandime të lëna, nga Subjekti janë pranuar të 38 rekomandimet nga të cilat: është zbatuar 1 masë ose 2.7% e tyre; 24 masa janë zbatuar pjesërisht; 9 masa janë në proces zbatimi dhe 4 masa janë pa zbatuar; pra 28 masa mbeten për tu zbatuar nga subjekti Bashkia Belsh për periudhën në vijim.

Grupi i auditimit duke analizuar Rekomandimet e pranuar dhe të zbatuara nga Bashkia Belsh (njësitë përgjegjëse të saj), arriti në konkluzionin që: për kategorinë “Masa Organizative”- Rekomandimet 3.1 dhe të rikërkuarat 1.1; 2.1; 3.1; 3.2; 10.1; 10.2; 10.3; 24.1; 25.1 të cilët janë pranuar nga subjekti – Bashkia Belsh, rezultojnë të zbatuar apo në proces, prandaj nuk mund të qëndrojnë për periudhën në vijim.

Më gjerësisht, auditimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon:

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË BELSH

- Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ”Bashkia Belsh ka kthyer përgjigje në KLSH për auditimin e mëparshëm me shkresën nr. 1149 datë 15.04.2022, brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës; për auditimin e fundit: me Urdhër të Brendshëm të kryetarit të Bashkisë Belsh me nr. 371/1prot., datë 06.02.2023 është ngritur grupi prej 5 anëtarësh, për hartimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

“planit të veprimit” dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të auditimit; Bashkia Belsh ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr.371/14 prot., datë 06.02.2023 brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

- Bashkia Belsh ka raportuar në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” dhe për masat e marra për zbatimin e tyre, me shkresë nr. 239 prot., datë 24.01.2023 me objekt “Raportim mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 515/18 prot., datë 08.09.2022. Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit”; Për “Gjetjet dhe rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” dërguar me shkresën nr. 1022/6 prot. datë 21.01.2023, nuk është raportuar në Këshillin Bashkiak.

- Nga ana e saj Bashkia Belsh iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë në datën 24.04.2023, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit” dërguar me shkresën nr. 1022/6 prot., datë 21.01.2023, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Belsh me nr. 371 prot., datë 02.02.2023. Nga auditimi rezultoi se ky raportim nuk është bërë, pasi është brenda afatit 6 mujor i cili përbushet në datën 03.08.2023.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Belsh nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Konkretisht janë konstatuar mangësi në 5 komponentët si vijon:

Mjedisi i kontrollit

- Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen e nivelit profesional të stafit.

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Nuk janë përcaktuar objektivat konkrete, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioneve të përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

Menaxhimi i Riskut

Nuk ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, duke mos marrë masa për evidentimin dhe minimizimin e risqeve që cenojnë realizimin e objektivave të institucionit. Mungesa e hartimit të regjistrit të riskut dhe plan-veprimit të MFK dhe riskut, ka sjellë mosidentifikimin dhe mosvlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm, me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut. Nuk ka raporte të Auditimit të Brendshëm, nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

- Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin.

Aktivitetet e Kontrollit

- Bashkia Belsh nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të TI për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të TI.

- Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të TI, pasi ka vetëm një specialist që mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari.

Informimi dhe komunikimi

- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesorë dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e situatës ekonomike, financiare etj., nga Kryetari i Bashkisë.

Monitorimi

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Në Bashkinë Belsh mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Nuk ka sektor të auditimit të brendshëm, për rrjedhojë nuk ka vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

1.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Belsh, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve të cilat mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të miratohen procedura për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (backup) si dhe për ruajtjen e tyre. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të përcaktohen rregulla të shkruara për llojet e raporteve të cilat duhet të përgatiten nga stafi për Titullarin, për të gjitha fushat e veprimtarinë së institucionit (të ardhurat, shpenzimet etj.).

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e rekomandimit ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/2 me nr. 371/3 prot., datë 06.02.2023, në të cilin ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore për të ndjekur zbatimin e tij; Është caktuar Koordinatori i Riskut, por nuk është zhvilluar ende takimi i GMS për hartimin e planit të masave për strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, ngritjen e një sistemi IT efektiv dhe të sigurt konform kërkesave specifike dhe nevojave institucionale; me dokumentin nr. 408/1 datë 10.02.2023 është hartuar dhe miratuar Plani vjetor i trajnimeve të stafit për vitin 2023.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Belsh, nuk ka strukturë për kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. Kryetari i Bashkisë Belsh, në mungesë të strukturës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

auditimit të brendshëm, për të realizuar kryerjen e shërbimit të auditimit të njësisë, nuk ka marrë masa për të lidhur marrëveshje me njësi të tjera publike të cilat kanë auditim të brendshëm, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja c), ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 64, shkronja a), si dhe VKM nr. 83, datë 3.2.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pikat 3 dhe 6, shkronja a).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Belsh, Njësinë e Auditimit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukture me personel të kualifikuar, të shikohet mundësia e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si p.sh. Bashkia Elbasan, Cërrik, Kuçovë, Lushnjë, etj.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/3 me nr.371/4 prot., datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e tij. Me Urdhrin nr. 1 datë 28.02.2023 dhe me nr. 626 prot., datë 28.02.2023 është miratuar struktura e re organizative, pjesë e së cilës është dhe Sektori i Auditit të Brendshëm. Drejtoria Ligjore dhe e burimeve njerëzore është në kontakt të vazhdueshëm me bashkitë e afërta për lidhjen e marrëveshjeve konform VKM nr. 83 datë 03.02.2016, por nuk është shpallur vendi vakant akoma.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjera, sipas nevojave të Bashkisë Belsh, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar. Këto veprime tregojnë për planifikime të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet jo real, jo të qëndrueshëm dhe jo efektiv. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42, 43, 47, 50, 52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253 dhe 354.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, në bashkëpunim me Drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, Drejtorinë e burimeve njerëzore dhe shërbimeve të brendshme, Drejtorinë e ndihmës ekonomike, arsimit, kulturës, turizmit dhe sportit, Drejtorinë e shërbimeve utilitare, komunitare dhe administrative, sektorin juridik dhe prokurimeve publike, etj., të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e rekomandimit të lënë nga KLSH ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/4 me nr. 371/5 prot., datë 06.02.2023 ku me anë të shkresave nr. 1039-1039/12 datë 11.04.2023, të gjitha njësitë e strukturës së Bashkisë Belsh janë njohur me tavanet buxhetore të shpenzimeve për Projekt buxhetin afatmesëm 2024-2026, për të shprehur sugjerimet e tyre si dhe ngarkohen për të paraqitur kërkesat mbi planifikimin e shpenzimeve të programeve respektiv.

Rekomandimi është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

4. Gjetje nga auditimi: 1. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, rezultoi se gjendja e debitorëve në Bashkinë Belsh është në vlerën 8,391,446 lekë, të evidentuara përkatësisht në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

2. Nga auditimi i të dhënave të disponueshme në sektorin e të ardhurave, rezultoi se në datën 31.12.2021, në Bashkinë Belsh janë 148 subjekte debitore nga biznesi, në vlerën 7,903,426 lekë, e cila është e pakontabilizuar, si dhe 1,581 familje për taksën e tokës bujqësore, taksën e ndërtesës, taksën e truallit dhe tarifa të ndryshme vendore, në vlerën 5,292,983 lekë, debitorë të tjerë nga toka bujqësore për taksë të planifikuar por të paarkëtuar, janë 2,850 familje në vlerën 64,489,485 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 104 subjekte në vlerën 2,128,184 lekë, etj. Këto shuma debitore janë të pakontabilizuara nga Bashkia Belsh dhe përbëjnë mungesë të ardhurash në vlerën totale 81,235,509 lekë. Bashkia Belsh nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitore të cilat rrjedhin nga taksat dhe tarifat vendore të cilat mblidhen nga Drejtoria e Taksave, në mospërputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104, neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në shumën prej 8,391,446 lekë, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i kryetarit nr.11/5 me nr. 371/6 prot., dhe 371/7 datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Sektori i Taksave dhe të Ardhurave Vendore. Janë marrë masat dhe po punohet për krijimin e një regjistri të plotë të të gjithë debitorëve. Nga ana e bashkisë na u bë me dije se mungesa e një sistemi IT ka sjellë pengesa për rakordim në kohë reale të llogarive

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh, të marrë të gjitha masat për të saktësuar vlerat e paraqitura nga grupi i auditimit të KLSH-së, si dhe për të kontabilizuar vlerën totale 81,235,509 lekë, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i kryetarit nr.11/5 me nr. 371/6 prot., dhe 371/7 datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Sektori i Taksave dhe të Ardhurave Vendore. Janë marrë masat dhe po punohet për krijimin e një regjistri të plotë të të gjithë debitorëve. Nga ana e bashkisë na u bë me dije se mungesa e një sistemi IT ka sjellë pengesa për rakordim në kohë reale të llogarive

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat financiare të Bashkisë Belsh nuk janë kontabilizuar aktivet afatgjata financiare, me vlerë kontabël 45,434,140 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, për “U. K. Belsh” SHA, në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” nenet 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 64, datë 22.07.2014 “Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, të Përmirësuara” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 8 “Të ardhurat”, pika 8, ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Belsh, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U. K. Belsh” SHA, me vlerë kontabël 45,434,140 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Belsh me shkresën nr. 130 datë 20.12.2022 të “U. K. Belsh” – sha është njoftuar për transferimin e aktivitetit të saj në “Shoqërinë Rajonale U. K. Rajoni Elbasan”-sha, në zbatim kjo të VKM nr. 302 datë 11.05.2022, ku do të transferohen gjithë kapitalet dhe aktiviteti i “U. K. Belsh” SHA; Gjithashtu për zbatimin e rekomandimit të KLSH ka dalë Urdhri i kryetarit nr. 11/7 me nr. 371/8 datë 06.02.2023 për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Sektorin e Taksave e të Ardhurave Vendore. Rezultoi se nga Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave nuk janë kryer veprimet e kontabilizimit të shumës 45,434,140 lekë në afatin e përcaktuar.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të lidhura për investimet në Bashkinë Belsh, rezultoi se për kontrata punimesh të lidhura nga Bashkia Belsh, projekti është kryer nga operatorë ekonomikë privatë, por nuk është kryer rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, si dhe nuk është bërë kontabilizimi i tyre si dhuratë, në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 57.

6.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh, të bëhet regjistrimi në kontabilitet i 2 projekteve të dhuruara, në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime” duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (marrëveshja/akti i dhurimit), si dhe Titullari I Institucionit të autorizojë rivlerësimin e tyre.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh, për zbatimin e rekomandimit ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/8 me nr. 371/9 prot., datë 06.02.2023 me anë të të cilit ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik e të Ardhurave të marrë masa për kontabilizimin e 2 projekteve në llog.202. Nga DZHEA na u bë me dije se “gjendur në statusin e një vështirësie të burimeve njerëzore, sidomos kjo në sektorin e Drejtorisë së Zhvillimit të Territori (Urbanistika), sikurse mund të referohemi edhe largimeve të fundit (me dorëheqje) e ka pasur të pamundur të ngre një grup të posaçëm dhe sa më të specializuar për përcaktimin sa më të saktë të projekteve të dhuruar gjatë viteve të aktivitetit të Bashkisë Belsh”.

Rekomandimi është pjesërisht zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit *për zbatimin e rekomandimeve*, në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evidentuara është dërguar nga ana e KLSH-së me Raport Përfundimtar, me shkresën nr. 1000/18 Prot. datë 24.03.2022. Nga auditimi i KLSH-së në Bashkinë Belsh, janë lënë gjithsej 35 rekomandime për përmirësimin e gjendjes, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Për 18 masa organizative, nga të cilat pikat: 22, 26, janë zbatuar pjesërisht, pikat: 1, 2, 3, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 23, 24 dhe 25 janë në proces zbatimi dhe pikat 6, 7, 8, 9 dhe 27 nuk janë zbatuar;

- Për 4 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,249,341 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, duke dërguar njoftimet përkatëse për pagesë vullnetare dhe janë në proces zbatimi;

- Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike për 160 subjekte në vlerën 3,988,885 lekë, e pakontabilizuar, 1,484 familje për taksë toke, takes ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 5,042,048 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,772 familje në vlerën 66,235,729 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 22 subjekte në vlerën 749,670 lekë, të cilat janë në proces zbatimi;

- Për 3 masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në të ardhurat e munguara në Bashkinë Belsh, në vlerën 37,500,399 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, janë në proces zbatimi dhe janë zbatuar pjesërisht;

- Për masat disiplinore për punonjësit e atakuar (i është rekomanduar kryetarit të bashkisë marrje masash disiplinore bazuar në shkeljet e konstatuara pa emra konkretë).

- Në bazë të rekomandimit për “Masa Disiplinore”, Kryetari i Bashkisë Belsh ka ngritur komisionin disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore sipas rasteve konkrete të punonjësve, bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të KLSH-së.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH-së”, germa j, ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1000/18 datë 24.3.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Belsh”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për moszbatimin e tyre.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, ka dalë Urdhri i Kryetarit nr. 11/9 me nr. 371/10 prot., datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohen gjithë menaxherët e njësisive të strukturës organizative të bashkisë si dhe komisioni i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të tyre. Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm përcjellë në RPA me shkresën nr. 1000/18 datë 24.03.2022 dhe regjistruar në Bashkinë Belsh me nr. 915 prot., datë 28.03.2022, verifikuar nga grupi i auditimit dhe vlerësuar me statusin “pjesërisht zbatuar”, “në proces zbatimi” dhe “pa zbatuar”, janë rikërkuar nga grupi i auditimit pasardhës në RPA me shkresën nr. 1022/6 datë 31.01.2023 dhe paraqiten si më poshtë:

I. MASA ORGANIZATIVE

1. (1.1) Rekomandimi: Drejtoria ekonomike, në bashkëpunim me Drejtorinë dhe Sektorët e tjerë në Bashki, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 12 datë 15.04.2022 ka urdhëruar që Drejtoria e Financave dhe të Ardhura Vendore në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) të kryejë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që të jenë të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Në proces zbatimi

2. (2.1) Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritetet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në Kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. (3.1) Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

4. (3.2) Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të Shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentimi i plotë në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 13, datë 15.04.2022 ka urdhëruar që Drejtoria e Financave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa për planifikimin e procedurave për investime, shërbime, për blerje mallrash, të cilat duhet të bëhen mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe shpërndarje e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve.

Në proces zbatimi

5 (6.1.) Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë të merren masa për nxjerrje Urdhrash për marrje në dorëzim nga një grup i specializuar, projektet dhe preventivat për të gjitha rastet për kontratat për punë civile, me qëllim të plotësimit të DT.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masa për të ngritur urdhra që nga momenti i marrjes dijeni të raportit përfundimtar dhe në vazhdim, për marrjen në dorëzim nga një grup i specializuar/i profilizuar për projektet dhe preventivat për kontratat e punëve civile që janë prokuruar.

Pa zbatuar

6. (7.1) Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e konstatuara, në lidhje me mospërcaktime të sakta të grafikut të punimeve. Në vijimësi në procedurat e prokurimit publik për kontrata për punë civile të merren masa që të respektohet grafiku i punimeve të përcaktuara nga projektuesi i objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masa për të ngritur urdhra që nga momenti i marrjes në dijeni të raportit përfundimtar dhe në vazhdim, për kontratat për punë civile që do të prokurohen të respektohet me përpikmëri grafiku i punimeve si nga ana e Autoritetit Kontraktor por edhe nga Sipërmarrësi i punimeve.

Pa zbatuar

7. (8.1) Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e konstatuara, në lidhje me mos përcaktime të sakta të fondit limit për kontratat për punë civile, si dhe në rastet në vijim të përcaktojë saktë vlerën e përlllogaritur të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masa për të ngritur urdhra që nga momenti i marrjes në dijeni të raportit përfundimtar dhe në vazhdim, për kontratat për punë civile që do të prokurohen të bëhen përcaktime të sakta të fondit limit nga grupet e ngritura më specialistë të fushës.

Pa zbatuar

8. (9.1) Rekomandimi: Bashkia Belsh të marrë masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë nuk ka marrë masa për të ngritur urdhra që nga momenti i marrjes dijeni të raportit përfundimtar dhe në vazhdim, duke prokuruar projekte të cilat janë hartuar më projektues më licencë përkatëse sipas objektit të prokurimit.

Pa zbatuar

9. (10.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh të merren masa që komunikimi ndërmjet institucioneve si dhe midis drejtorive të saj, të kryhet në mënyrë shkresore, me qëllim dokumentimin dhe zyrtarizmin e veprimeve, duke lënë gjurmën e auditimit.

10. (10.2) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh të merren masa që përpara fillimit të procedurave të prokurimit publik për kontrata për punë civile dokumentacioni teknik, pjesë përbërëse e dokumenteve standarde të tenderit si projektet, preventivat, relacionet e ndryshme teknike, të jenë të zyrtarizuara.

11. (10.3) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh të merren masa për mos fillimin e procedurave të prokurimit për kontrata për punë civile, pa pasur më parë të depozituar pranë kësaj Bashkie oponencën teknike sipas rastit, me reflektimet përkatëse të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë ka urdhëruar që të gjithë Drejtoritë e Bashkisë Belsh, të kenë komunikim nëpërmjet tyre dhe institucioneve në mënyrë shkresore, për të zyrtarizuar dhe dokumentuar veprimet e tyre. Zbatimi i rekomandimit mbetet për periudhën në vijim.

Në proces zbatimi edhe në vijimësi

12. (13.1) Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh të bëhet sistemimi në kontabilitet, respektivisht për:

- llogarinë nr. 231 “Investime në proces” dhe llogarinë nr. 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 85,321,966 lekë të 3 objekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.215 dhe në kredi të llogarisë nr. 251.

- llogarinë nr. 230 “Investime në proces” dhe llogarinë nr. 202 “Studime dhe kërkime” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 3,445,200 lekë të 3 projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 dhe në kredi të llogarisë nr.230.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh ka ngritur Urdhrin nr. 14, datë 15.04.2022, ku është urdhëruar Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave Vendore që të marrë masa për hedhjen e këtyre vlerave kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2022 pasi pasqyrat financiare të vitit 2021 janë mbyllur dhe dorëzuar përpara se të vinte raporti përfundimtar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Në proces zbatimi, në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

13. (14.1) Rekomandimi: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr. 231 për shumën prej 19,444,097 lekë, të shpronësimeve të likuiduara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe në momentin e përfundimit të projektit “Ansambli i Rilindjes Urbane Belsh”, vlera e plotë e investimit të kapitalizohet te klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me Urdhrin nr. 15, datë 15.04.2022 ku është urdhëruar Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave Vendore që të marrë masa për kryerjen e veprimit kontabël në debi të llogarisë nr. 231 në vlerën 19,444,097 lekë lidhur me shpronësimet e likuiduara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe në përfundim të kapitalizohet tek klasa e aktiveve afatgjata materiale.

Në proces zbatimi, në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

14. (16.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me Urdhrin nr. 17, datë 15.04.2022 është urdhëruar Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me specialistin e magazinës të krijojnë një regjistër kontabël ku të shënohen aktivet e njësisë dhe të specifikohet në mënyrë analitike secili aktiv.

Në proces zbatimi

15. (17.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa nga Titullari i Institucionit ku të nxirren përgjegjësitë për komisionet që kanë kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve me profil drusor dhe metalik duke mos i bërë hyrje në magazinë dhe më pas të shiteshin në formë ankandi. Grupi i Menaxhimit Strategjik, për vitin ekzistues të hartojë një procedurë të drejtë dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, për komisionet që do të ngarkohen për vlerësimin dhe asgjësimin e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 18 Prot., datë 15.04.2022 ka urdhëruar Grupin e Menaxhimit Strategjik në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe të Ardhurave Vendore të hartojnë një procedurë të drejtë, mbështetur në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e sektorit Publik”, për vlerësimin dhe asgjësimin e materialeve të propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

Në proces zbatimi



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

16. (20.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të merren masa që të evidentohen detyrimet në pasqyrat financiare duke i njohur në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 270,312,270 lekë për vitin ushtrimor 2020. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021. Nga ana e Bashkisë Belsh, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 20, datë 15.04.2022 ka urdhëruar Drejtorinë e Financës dhe të Ardhurave Vendore të bëjë saktësimin e detyrimeve që rrjedhin nga shpronësimet për realizimin e projekteve publike në pasqyrat financiare të vitit 2022 pasi pasqyrat financiare të vitit 2021 janë mbyllur dhe dorëzuar përpara se të vinte raporti përfundimtar nga Kontrolli i Lartë i shtetit dhe kontabilizimi i tyre në llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Në proces zbatimi edhe në vijimësi

17. (22.1) Rekomandimi: Bashkia Belsh duhet të marrë masa që në të ardhmen të kryejë një proces planifikimi sa më real si dhe më kryesorja të ketë rritje të nivelit të të ardhurave dhe arkëtimit të tyre duke kryer periodikisht analiza për ecurinë duke nxjerrë objektivat përkatëse, në mënyrë të tillë që në fund të periudhave ushtrimore të ulet gjendja e faturave të palikuiduara dhe borxhi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 21, datë 15.04.2022 ka urdhëruar Drejtorinë e Financës dhe të Ardhurave Vendore që në bashkëpunim me Sektorin e tatim-taksave të bëjnë planifikim sa më real për njoftimin tatimpaguesve familjarë nëpërmjet dërgimit në rrugë postare në mënyrë që të ketë rritje të të ardhurave.

Zbatuar pjesërisht

18. (23.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe rrisin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërorë. Për të gjitha detyrimet e mundshme për t'u ri kërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e Bashkisë Belsh. Të zbatohen plotësisht rekomandimet e përealizuara dhe ri kërkuara nga KLSH-ja me shkresën nr. 06/9, datë 14.05.2018 të KLSH-së.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditi i ushtruar në vitin 2018 nuk është marrë asnjë masë nga propozimet e APP-së për dënimet me gjobë për 18 persona, pasi procedurat në të cilën këta persona kanë qenë i përfshirë, janë në proces hetimor nga prokuroria bazuar në shkresën nr. 1675 Prot., datë 25.06.2018, me vendim sekuestrimi i dosjeve, për këtë arsye nuk është kryer asnjë veprim i mëtejshëm nga ana e Bashkisë.

Në proces zbatimi

19. (24.1) Rekomandimi: Nga DPZHT Bashkia Belsh të merren masa konkrete për: - mos lëshimin e lejeve të ndërtimit pa u pajisur fillimisht me vërtetim për Riskun. - mos lëshimin e lejeve të ndërtimit pa u pajisur me miratimet nga institucionet që duhet. - mos lëshimin e lejeve të ndërtimit pa u respektuar distanca nga objekti me kufirin e pronës si dhe distanca nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

objekti në objekt. - mos lëshimin e lejeve të ndërtimi pa u zbatuar koeficienti i shfrytëzimit dhe intensitetit të lejuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh në urdhrin e brendshëm nr. 3, datë 14.04.2022 ka Urdhëruar Drejtorinë e Urbanistikës që të mos lëshojë më leje ndërtimi: 1. pa u pajisur me vërtetim për riskun, 2. pa marrë miratimin e institucioneve përkatëse, 3. të respektohet distanca nga objekti në objekt dhe nga objekti me kufijtë e pronës. Por akoma nuk janë dhënë leje për verifikimin e rekomandimit.

Në proces zbatimi

20. (25.1) Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojmë leje infrastrukturore vetëm atëherë kur të jetë hartuar dhe plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko ligjor të parashikuar në kuadrin ligjor në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 3 datë 14.04.2022 ka urdhëruar Drejtorinë e Urbanistikës që të mos lëshojë më leje infrastrukturore pa qenë i plotësuar i gjithë dokumentacioni tekniko-ligjor të parashikuar në fushën e planifikimit dhe kontrollit të territorit. Por akoma nuk janë dhënë leje për verifikimin e rekomandimit.

Në proces zbatimi

21. (26.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, bazuar në faktin që kontrata e shërbimit është në proces (5 vite) të merren masa për rakordimin e diferencës, nga Kontraktori “K” SHPK vlerë kjo e cila duhet të argumentohet saktë në dokumentacionin justifikues dhe në situacionet mujore progresive të zërave të shërbimeve pa rritur ose zvogëluar vlerën 26,989 lekë sipas përcaktimeve të aneksit nr. I të kontratës në situacion mujor.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën me nr. 1031 datë 07.04.2022 është dërguar shkresë kontraktorit “K” ShPK ku i kërkohet saktësimi i diferencës dhe argumentimi i saktë në situacionet mujore progresive të zërave të shërbimeve.

Zbatuar pjesërisht

22. (27.1) Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë volumet për zërat e punimeve në objektin “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Seferan” të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave (fakt-librezë) nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, dhe të realizohet pasqyrimi me saktësi sipas faktit në librezën e masave.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Belsh me urdhrin nr. 4 datë 14.04.2022 ka urdhëruar Drejtorinë e urbanistikës që në bashkëpunim me një grup pune me përbërje po nga kjo zyrë së bashku me sipërmarrësin dhe mbikëqyrësin e punimeve që të bëjnë saktësimin e zërave të punimeve të përcaktuara si të paargumentuar në raport dhe pasqyrimi i tyre në librezën e masave.

Pa zbatuar

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi, lëshuar Urdhrat e Shpërblimit të dëmit për pagesën në mënyrë vullnetare në vlerën 1,249,341 lekë, në të kundërtën do të bëhen paditë ligjore, sipas rekomandimeve të KLSH, si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

1. (1.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 234,221 lekë pa TVSH nga Kontraktori JV “E.” ShPK& “I.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. -- prot, datë 07.08.2019 të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri”, Bashkia Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera jo në përputhje me specifikimet teknike.*

2. (2.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 324,400 lekë pa TVSH nga Kontraktori BOE “C.” ShPK& “B.” ShPK& “E.” ShPK, përfaqësuar nga OE “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1737/12 prot, datë 07.08.2019 të kontratës me objekt “Furnizimi me ujë të pijshëm i Zonës së Dumresë, Bashkia Belsh, (Faza e Parë)”, Bashkia Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.*

3.(3.1) Rekomandimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikualifikim Urban i Fasadave të Qendrës Belsh”, me vlerë 21,102,624 lekë me TVSH, fituar nga BOE “F.C. Shpk” & “V.H.” ShPK, rezultuan diferenca volumesh në zëra punime ndërtimi si dhe volume të paargumentuara, në vlerën 559,320 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 291/11 prot datë 30.01.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Belsh dhe BOE “F.C. Shpk” & “V.H.” Shpk. 604.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 559,320 lekë pa TVSH nga BOE “F.C. Shpk” & “V.H.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 291/11 prot, datë 30.01.2019 të kontratës me objekt “Rikualifikim Urban i Fasadave të Qendrës Belsh”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara apo me të argumentuara me dokumentacion teknik, si foto, proces verbal, etj.*

Deri më datë 30.05.2022

4. (4.1) Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 131,400 lekë pa TVSH nga OE “V. H.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 181/6 prot, datë 18.08.2017 të kontratës me objekt “Ndërtim, sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.*

Deri më datë 30.05.2022

Nga verifikimi rezultoi se: Bazuar në rekomandimin nr. 1, 2, 3 dhe 4, është ngritur Urdhri nr. 5, datë 14.04.2022 ku është urdhëruar Sektori i Tatim-taksave dhe Zyra juridike të bëjnë njoftimet për pagesën vullnetare të vlerës (shpërblim dëmi) prej ngarkuar për secilin subjekt (3 subjektet) dhe zyra Juridike të bëjë paditë ligjore në një fazë të mëvonshme nëse këto pagesa nuk kryen vullnetarisht. Me shkresat nr. 1578-1581, datë 31.05.2022 është dërguar shkresë 4 subjekteve të lartpërmendur nga sektori i taksave dhe tatimeve për njoftim pagese vullnetare pranë bashkisë, duke iu njoftuar dhe masa shpërblim dëmi.

Në proces zbatimi

IV. MASA PËR ELEMENIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSA DHE TARIFA VENDORE NE TE ARDHURAT E MUNGUARA NE BASHKINË BELSH.

1. (2.1) Rekomandimi: Bashkia Belsh të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 1,753,576 lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për 4 operatorë ekonomikë, që janë pajisur me leje minerare nga MIE respektivisht për



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

subjektet si më poshtë: - Subjekti “A.D.” ShPK, për vlerën prej 84,216 lekë; - Subjekti “J.” ShPK, për vlerën prej 154,000 lekë; - Subjekti “I.E.” ShPK, për vlerën prej 1,203,840 lekë; - Subjekti “H.” ShPK, për vlerën prej 311,520 lekë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Bazuar në rekomandimin nr. 2, është ngritur Urdhri nr. 10, datë 14.04.2022, ku është urdhëruar Sektori i Tatim-taksave të marrë masa për arkëtimin e shumë prej 1,753,576 lekë, si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për 4 operatorë ekonomik të pajisur me leje minerare nga MIE. Me shkresat me nr. 1653-1656 datë 07.06.2022 është dërguar shkresë 4 subjekteve të lartpërmendur nga sektori i taksave dhe tatimeve për njoftim, për arkëtimin e taksave dhe tarifave për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore.

Në proces zbatimi

Pra: nga verifikimi rezultoi se Rekomandimet e rikërkua nga grupi i mëparshëm i auditimit, rezultuan në të njëjtin status.

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Sektori i Taksave Vendore, Bashkia Belsh, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Kështu referuar të dhënave të pasqyrave të mësipërme, konstatojmë se ka mospërputhje të madhe midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki për të grumbulluar evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave. Këto veprime kanë çuar në mosplanifikim të taksës së tokës bujqësore për diferencën prej 27,163,823 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh, në mospërputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Belsh, të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej 27,163,823 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh.

Brenda datës 30.6.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i Kryetarit nr. 11/10 me nr.371/11 prot., datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori i Taksave dhe tarifave për marrjen e masave për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore me qëllim planifikimin e vjeljes së detyrimit prej 27,163,823 lekë. Me VKB nr. 69 datë 21.12.2022 është miratuar “paketa fiskale 2023”. Janë marrë masat dhe nga zyra e taksave po punohet për krijimin e regjistrave të personave që posedojnë tokë bujqësore me të gjitha specifikimet. Kanë përfunduar 2 njësi administrative dhe po punohet edhe për 3 njësitë e tjera.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezultojnë se më datën 31.12.2021 për mospagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Belsh në vlerën gjithsej 81,235,509 lekë, janë debitorë 148 subjekte nga biznesi në vlerën 7,903,426 lekë, e cila është e pa kontabilizuar, si dhe 1581 familje për taksën e tokës bujqësore, taksën e ndërtesës, taksën e truallit dhe tarifa të ndryshme vendore, në vlerën prej 5,292,983 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,850 familje në vlerën 64,489,485 lekë, (taksë e planifikuar por e paarkëtuar), si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 104 subjekte në vlerën 2,128,184 lekë, etj., të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash në vlerën totale 81,235,509 lekë. Sektori i Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Belsh, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, ka zbatuar vetëm procedurën e bllokimit të llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë dhe asnjë procedurë tjetër, ku dhe kjo procedurë që në fillimet e saj rezultojnë e dështuar pasi sidomos për abonentët familjarë nuk kanë të deklaruar pranë sektorit të taksave nr. llogarie bankare për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo nëpërmjet bankës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104, neni 70, pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, ligji nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

2.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Belsh të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura për 148 subjekte biznesi në vlerën 7,903,426 lekë, 1581 familje për taksën e tokës bujqësore, taksën e ndërtesës, taksën e truallit dhe tarifa të ndryshme vendore, në vlerën prej 5,292,983 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,850 familje në vlerën 64,489,485 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 104 subjekte në vlerën 2,128,184 lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime në llogarit bankare;
- T’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;
- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Brenda datës 30.6.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/11 me nr. 371/12 prot., datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohen Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore në bashkëpunim me Zyrën Juridike për marrjen e masave administrative dhe ligjore, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga; Nga auditimi rezultoi se për 148 biznese debitorë në vlerën e detyrimit 7,903,426 lekë është mundur të arkëtohen 4,896,716 lekë nga 71 subjekte. Vlera e mbetur e detyrimit është 3,006,710 lekë për 77 subjekte debitorë; Për 1581 familje debitorë në vlerën e detyrimit 5,292,983 lekë janë mundur të arkëtohen 1,861,102 lekë nga 129 familje dhe vlera e detyrimit të mbetur është 3,431,881 lekë për 1452 familje. Për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga 104 debitorë me vlerën 2,128,184 lekë kanë shlyer detyrimin 19 familje debitorë në vlerën



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

719,177 lekë, duke e ulur numrin e debitorëve në 85 me një detyrim të mbetur 1,409,007 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, kanë mangësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Belsh, nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet në shumën prej 7,400,000 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Belsh. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe nenin 35, të VKM-së nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitore prej 7,400,000 lekë, sipas Aneksit B18 bashkëlidhur Projekt-raportit të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda datës 30.6.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i Kryetarit nr.11/12 me nr. 371/13 prot., datë 06.02.2023, me anë të të cilit ngarkohen Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për marrjen e masave për arkëtimin e plotë të detyrimeve të papaguara; gjithashtu në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik për ndërmarrjen e veprimeve administrative e ligjore në rastin e mos shlyerjes së detyrimeve nga ana e subjekteve debitore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se janë 16 subjekte aktive në QKB, kanë paguar kështu e mbetura 5 subjekte në vlerën 8,500,000 lekë dhe ka mbetur për tu arkëtuar vlera debitore 4,600,000 lekë.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor nëshërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh, që për shkeljet e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

paraqituranë Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, tëvlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat përdhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. A.N. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, me menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

2. Z. M.Ç. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm;

3. Z. A.S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

4. Z. D.P., me detyrë Përgjegjës të Sektorit të të ardhurave, në lidhje me vjeljen, menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;

5. Z. J.T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të prokurimeve, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

6. Znj. A.L. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit juridik, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

7. Z. V.I. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të lejeve, në Drejtorinë e urbanistikës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo mestatus të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, kontratën individuale të punës, neni 8 “Masat Disiplinore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh, që përshkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje e kontratës së punës”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. R.M. me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Belsh, për mosmarrjen e masave të plota në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Belsh për zbatimin e këtij rekomandimi ka dalë Urdhri i Kryetarit nr. 371/2 me nr. 11/1prot., datë 06.02.2023, për ngritjen e komisionit disiplinor. Komisioni është duke shqyrtuar dokumentacionin për secilin punonjës, mbi të cilin i është rekomanduar kryetarit të bashkisë marrja e masave disiplinore.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

E. Njoftim për Departamentin e Administratës Publike dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Përderisa Komisioni Disiplinor nuk ka nxjerrë ende vendimet, pasi procedura është në proces, Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, do të njoftohen në përfundim të procedurës.

Konkluzioni: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në RPA, rezultoi se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

1. Rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme dhe të rikërkua nga grupi i fundit i auditimit, rezultuan në të njëjtin status dhe me një realizim të ulët prej 3%;

Në gjykimin e grupit të KLSH –së ky nivel i ulët ka ardhur si rezultat i mungesës së analizës së gjetjeve të konstatuara nga ana e Kryetarit të Bashkisë, GMS dhe strukturave të bashkisë Belsh të ngarkuara me përgjegjësi; mungesës së bashkëpunimit mes strukturave dhe drejtorisë ligjore, për të hartuar plane masash efektive.

III.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Belsh për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar dhe të Përputhshmërisë” dërguar meshkresënr. 1000/18prot., datë 24.03.2022 dhe nr. 1022/6 prot, datë 31.01.2023, rezulton se subjekti i audituar ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, **por nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak) për auditimin e dërguar me shkresë nr. 1022/6 prot. datë 21.01.2023, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Belsh për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 1000/18 prot., datë 24.03.2022 dhe nr. 1022/6 prot, datë 31.01.2023, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjorederi në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASAORGANIZATIVE

1. Rekomandimi nr. 1.1: Nga Titullari i Bashkisë Belsh, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve të cilat mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të miratohen procedura për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) si dhe për ruajtjen e tyre. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të përcaktohen rregulla të shkruara për llojet e raporteve të cilat duhet të përgatiten nga stafi për Titullarin, për të gjitha fushat e veprimtarinë së institucionit (të ardhurat, shpenzimet etj.).

Menjëherë

2. Rekomandimi nr. 2.1: Kryetari i Bashkisë Belsh, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Belsh, Njësinë e Auditimit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukture me personel të kualifikuar, të shikohet mundësia e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si p.sh. Bashkia Elbasan, Cërrik, Kuçovë, Lushnjë, etj.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

3. Rekomandimi nr. 4.1: Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në shumën prej 8,391,446 lekë, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

4. Rekomandimi nr. 4.2: Drejtoria e Financës në Bashkinë Belsh, të marrë të gjitha masat për të saktësuar vlerat e paraqitura nga grupi i auditimit të KLSH-së, si dhe për të kontabilizuar vlerën totale 81,235,509 lekë, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Menjëherë

5. Rekomandimi nr. 5.1: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Belsh, të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U.K. Belsh” SHA, me vlerë kontabël 45,434,140 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë

6. Rekomandimi nr. 6.1: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh, të bëhet regjistrimi në kontabilitet i 2 projekteve të dhuruara, në llogarinë nr. 202 “Studime dhe Kërkime” duke u bazuar në dokumentacion shoqërues (marrëveshja/akti i dhurimit), si dhe Titullari i Institucionit të autorizojë rivlerësimin e tyre.

Menjëherë

Gjetje nga auditimi:² Nga verifikimi i dokumentacionit *për zbatimin e rekomandimeve*, në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evidentuara është dërguar nga ana e KLSH-së me Raport Përfundimtar, me shkresën nr. 1000/18 Prot. datë 24.03.2022. Nga auditimi i KLSH-së në Bashkinë Belsh, janë lënë gjithsej 35 rekomandime për përmirësimin e gjendjes, të cilat paraqiten si më poshtë:

- *Për 18 masa organizative*, nga të cilat pikat: 22, 26, janë zbatuar pjesërisht, pikat: 1, 2, 3, 10, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 23, 24 dhe 25 janë pjesërisht zbatuar dhe pikat 6, 7, 8, 9 dhe 27 nuk janë zbatuar;

- *Për 4 masa për shpërblim dëmi* në vlerën 1,249,341 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, duke dërguar njoftimet përkatëse për pagesë vullnetare dhe janë pjesërisht zbatuar;

- *Për 1 masë për eliminimin e efekteve* negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike për 160 subjekte në vlerën 3,988,885 lekë, e pakontabilizuar, 1,484 familje për taksë toke, takes ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej 5,042,048 lekë, debitorë nga toka bujqësore 2,772 familje në vlerën 66,235,729 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 22 subjekte në vlerën 749,670 lekë, të cilat janë në proces zbatimi;

- *Për 3 masa për eliminimin e subjekteve* lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në të ardhurat e munguara në Bashkinë Belsh, në vlerën 37,500,399 lekë, të cilat janë pranuar plotësisht, janë në proces zbatimi dhe janë zbatuar pjesërisht;

- *Për masat disiplinore* për punonjësit e atakuar, i është rekomanduar kryetarit të bashkisë marrje masash disiplinore bazuar në shkeljet e konstatuara pa emra konkretë.

²Në kuadrat janë Rekomandimet e lëna në RPA me shkresën nr. 1000/18 Prot. datë 24.03.2022 dhe rikërkuar nga grupi auditues paraardhës në RPA me shkresën nr. 1022/6 datë 31.01.2023 për kategoritë “Masa Organizative”, “Shpërblim dëmi” dhe “Masa për eliminimin e subjekteve lidhur me llogaritjen e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore në të ardhurat e munguara”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

-Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Belsh të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve pjesërisht zbatuar dhe të pazbatuara, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1000/18 prot. Datë 24.03.2022 në RPA dhe rikërkuar në RPA me shkresën nr. 1022/6 datë 31.01.2023 lidhur me “Zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Belsh”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **18 masa** organizative.

- **8 masa** mungesë të ardhurash në vlerën **114,766,072 lekë**.

Menjëherë

Nga auditimi, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të rikërkuar, rezultoi se rekomandimet ishin në të njëjtin status me atë të lënë nga grupi i fundit i auditimit në RPA me nr. 1022/6 datë 31.01.2023 prandaj i rikërkojmë:

7. Rekomandimi nr. 6.1: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë të merren masa për nxjerrje Urdhrash për marrje në dorëzim nga një grup i specializuar, projektet dhe preventivat për të gjitha rastet për kontratat për punë civile, me qëllim të plotësimit të DT.

Menjëherë

8. Rekomandimi nr. 7.1: Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e konstatuara, në lidhje me mospërcaktime të sakta të grafikut të punimeve. Në vijimësi në procedurat e prokurimit publik për kontrata për punë civile të merren masa që të respektohet grafiku i punimeve të përcaktuara nga projektuesi i objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Rekomandimi nr. 8.1: Titullari i Autoritetit Kontraktor të analizojë shkaqet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për rastet e konstatuara, në lidhje me mos përcaktime të sakta të fondit limit për kontratat për punë civile, si dhe në rastet në vijim të përcaktojë saktë vlerën e përlloragitur të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Rekomandimi nr. 9.1: Bashkia Belsh të marrë masa për të operuar vetëm me projekte të zbatimit të hartuara nga projektues, të pajisur me licencat përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Rekomandimi nr. 13.1: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh të bëhet sistemimi në kontabilitet, respektivisht për:

- llogarinë nr. 231 “Investime në proces” dhe llogarinë nr. 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 85,321,966 lekë të 3 objekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.215 dhe në kredi të llogarisë nr. 251.

- llogarinë nr. 230 “Investime në proces” dhe llogarinë nr. 202 “Studime dhe kërkime” me mbylljen e bilancit të vitit pasardhës, për vlerën kontabël prej 3,445,200 lekë të 3 projekteve të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr.202 dhe në kredi të llogarisë nr.230.

Menjëherë

12. Rekomandimi nr. 14.1: Nga Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Belsh të bëhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë nr. 231 për shumën prej 19,444,097 lekë, të shpronësimeve të likuiduara nga



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe në momentin e përfundimit të projektit “Ansambli i Rilindjes Urbane Belsh”, vlera e plotë e investimit të kapitalizohet te klasa e Aktiveve Afatgjata Materiale.

Menjëherë

13. Rekomandimi nr. 16.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa nga Nëpunësi Zbatues ku të krijohet e mbahet regjistri i aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

14.Rekomandimi nr. 17.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa nga Titullari i Institucionit ku të nxirren përgjegjësitë për komisionet që kanë kryer nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve me profil drusor dhe metalik duke mos i bërë hyrje në magazinë dhe më pas të shiteshin në formë ankandi. Grupi i Menaxhimit Strategjik, për vitin ekzistues të hartojë një procedurë të drejtë dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, për komisionet që do të ngarkohen për vlerësimin dhe asgjësimin e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Menjëherë

15. Rekomandimi nr. 20.1: Nga Bashkia Belsh, nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike, të merren masa që të evidentohen detyrimet në pasqyrat financiare duke i njohur në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Nga Drejtoria Ekonomike të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë nr. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe kundër partisë së saj 467 “Kreditorë të ndryshëm” për shumën 270,312,270 lekë për vitin ushtrimor 2020. Këto veprime të kryhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021. Nga ana e Bashkisë Belsh, pas saktësimin të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave.

Menjëherë

16. Rekomandimi nr. 22.1: Bashkia Belsh duhet të marrë masa që në të ardhmen të kryejë një proces planifikimi sa më real si dhe më kryesorja të ketë rritje te nivelit të të ardhurave dhe arkëtimit të tyre duke kryer periodikisht analiza për ecurinë dukenxjerrë objektivat përkatëse, në mënyrë të tillë që në fund të periudhave ushtrimore të ulet gjendja e faturave të palikuiduara dhe borxhi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Rekomandimi nr. 23.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe rrisin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për t'u ri kërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e bashkisë Belsh. Të zbatohen plotësisht rekomandimet e përcaktuara dhe ri kërkuara nga KLSH-ja me shkresën nr. 06/9, datë 14.05.2018 të KLSH-së.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

18.Rekomandimi nr. 26.1: Nga Bashkia Belsh, bazuar në faktin që kontrata e shërbimit është në proces (5 vite) të merren masa për rakordimin e diferencës, nga Kontraktori “K” SHPK vlerë kjo e cila duhet të argumentohet saktë në dokumentacionin justifikues dhe në situacionet mujore progresive të zërave të shërbimeve pa rritur ose zvogëluar vlerën 26,989 lekë sipas përcaktimeve të aneksit nr. I të kontratës në situacion mujor.

Menjëherë

19. Rekomandimi nr. 27.1: Titullari i Bashkisë Belsh, të marrë masa që të ngrejë grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, që të vlerësojnë e të analizojnë volumet për zërat e punimeve në objektin “Rikonstruksionii i shkollës 9-vjeçare Seferan” të cilat rezultuan të paargumentuara qartësisht në librezën e masave (fakt-librezë) nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, dhe të realizohet pasqyrimi me saktësi sipas faktit në librezën e masave.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Janë rekomanduar 4 masa për shpërblim dëmi, lëshuar Urdhrat e Shpërblimit të dëmit për pagesën në mënyrë vullnetare në vlerën 1,249,341 lekë, në të kundërtën do të bëhen paditë ligjore, sipas rekomandimeve të KLSH, si më poshtë:

1. Rekomandimi nr. 1.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 234,221 lekë pa TVSH nga Kontraktori JV “E.” ShPK& “I.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. -- prot, datë 07.08.2019 të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri”, Bashkia Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera jo në përputhje me specifikimet teknike.*

Menjëherë

2. Rekomandimi nr. 2.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 324,400 lekë pa TVSH nga Kontraktori BOE “C.” ShPK& “B.” ShPK& “E.” ShPK, përfaqësuar nga OE “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1737/12 prot, datë 07.08.2019 të kontratës me objekt “Furnizimi me ujë të pijshëm i Zonës së Dumresë, Bashkia Belsh, (Faza e Parë)”, Bashkia Belsh, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.*

Menjëherë

3. Rekomandimi nr. 3.1: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikualifikim Urban i Fasadave të Qendrës Belsh”, me vlerë 21,102,624 lekë me TVSH, fituar nga BOE “F.C. Shpk” & “V.H.” ShPK, rezultuan diferenca volumesh në zëra punime ndërtimi si dhe volume të paargumentuara, në vlerën 559,320 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 291/11 prot datë 30.01.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Belsh dhe BOE “F.C. Shpk” & “V.H.” ShPK. 60 4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 559,320 lekë pa TVSH nga BOE “F.C. ShPK” & “V.H.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 291/11 prot, datë 30.01.2019 të kontratës me objekt “Rikualifikim Urban i Fasadave të Qendrës Belsh”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, *si rrjedhojë e situacionimit të*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

punimeve të pakryera në volumet e situacionuara apo me të argumentuara me dokumentacion teknik, si foto, proces verbal, etj.

Menjëherë

4. Rekomandimi nr. 4.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 131,400 lekë pa TVSH nga OE “V. H.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 181/6 prot, datë 18.08.2017 të kontratës me objekt “Ndërtim, sistemim, asfaltim i rrugëve të brendshme, Bashkia Belsh”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik në buxhetin e njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera në volumet e situacionuara.

Menjëherë

C. MASA PËR ELEMENIMIN E SUBJEKTEVE LIDHUR ME LLOGARITJEN E DETYRIMEVE PËR TAKSA DHE TARIFA VENDORE NE TE ARDHURAT E MUNGUARA NË BASHKINË BELSH.

1. Rekomandimi nr. 2.1: Bashkia Belsh të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 1,753,576 lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave për shfrytëzim të sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për 4 operatorë ekonomikë, që janë pajisur me leje minerare nga MIE respektivisht për subjektet si më poshtë: - Subjekti “A.D.” ShPK, për vlerën prej 84,216 lekë; - Subjekti “J.” ShPK, për vlerën prej 154,000 lekë; - Subjekti “I.E.” ShPK, për vlerën prej 1,203,840 lekë; - Subjekti “H.” ShPK, për vlerën prej 311,520 lekë.

Menjëherë

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Rekomandimi nr. 1.1: Bashkia Belsh, të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie të ndarjes së tokës bujqësore sipas të dhënave të sektorit të bujqësisë për planifikimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore në shumën prej 27,163,823 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Belsh.

Brenda datës 30.12.2023

2. Rekomandimi nr. 2.1: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Belsh të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura për 77 subjekte debitorë biznesi në vlerën 3,006,710 lekë, 1452 familje në vlerën 3,431,881 lekë për taksën e tokës bujqësore, taksën e ndërtesës, taksën e truallit dhe tarifa të ndryshme vendore, debitorë nga toka bujqësore 2,850 familje në vlerën 64,489,485 lekë, si dhe nga taksa mbi ndikimin në infrastrukturë 85 subjekte në vlerën 1,409,007 lekë, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokime ne llogarit bankare;
- T’i dërgohet Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosje barrë siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme);
- Në funksion mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhojë strukturat e tij, për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore dhe “Sektori Juridik”, të marrin masa administrative, apo sekuestro dhe pas shterimit të këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Brenda datës 30.12.2023

3. Rekomandimi nr. 3.1: Nga Bashkia Belsh, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitore prej 4,600,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda datës 30.12.2023

E. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil: Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor nëshërbimit civil”, **i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh**, që për shkeljet e paraqitur në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat përdhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. A.N. Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licensave, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me planifikimin dhe realizimin e buxhetit, me menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor si dhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

2. Z. M.Ç. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm;

3. Z. A.S. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

4. Z. D.P., me detyrë Përgjegjës të Sektorit të të ardhurave, në lidhje me vjeljen, menaxhimin e të ardhurave dhe borxhin tatimor;

5. Z. J.T., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të prokurimeve, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

6. Znj. A.L., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit juridik, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së;

7. Z. V.I. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të lejeve, në Drejtorinë e urbanistikës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, kontratën individuale të punës, neni 8 “Masat Disiplinore”, i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Belsh, që përshkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin shkëlqejve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje e kontratës së punës”, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. R.M. me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Belsh, për mosmarrjen e masave të plota në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i KLSH-së.

C.3Nga Kryetari i Bashkisë Belsh **kërkojmë** vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar sipas Planit të masave të miratuar.

Menjëherë

Nr	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Paparuar subjekti		Shkalla e pranimit në %	Statusi i rekomandimeve të pranuar									
		Nr	Vlera lekë	Nr	Vlera	Nr	Vlera		Zbatuar		Pjesërisht/Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
									Nr	Vlera	Nr	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr	Vlera	Nr	Vlera
1	Masa organizative	29	0	29	0	0	0	100	1	-	14 / 9			5		0		
2	Masa shpërblim dëmi	4	1,249,341	4	1,249,341				0		4	1,249,341					0	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
3	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	3	114,377,901	3	114,377,901	0	0	100	0	0	3	104,100,906	10,276,995				0	
4	Mungesë të ardhurat	1	1,753,576	1	1,753,576						1	1,753,576			0		0	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
5	Masa disiplinore	1	0	1	0	0	0	100	1	-	1				0		0	
	- Me Status Nënpunësi Civil/punonjes																	
	- Me kontratë pune/punonjes																	
6	Masa Administrative	0	0			0					0						0	
	- Nga APP																	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
	-Nga IMTV																	
	<i>Nga të cilat pa kontabilizuar</i>																	
11	Tjera	0	0						0	0							0	
	TOTALI	38	117,380,818	38	117,380,818	0		100	1		23 / 9	107,103,823	10,276,995		5		0	

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike										
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër	Zbatupjesëri sht numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar pjesërisht/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal në 00/lek	Pazbatuar (Pa fill proced)			
							Nr. Pers/ taks	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë		
a	b																
I.	Në fushën e legjislacionit	0					0										0
1	Shfuqizim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Përmirësim akti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
II.	MASA ORGANIZATIVE (Gjithsejt, Ne vlere)	29	29	1	23	5	0	0									0
III.	MASA SHPERBLIM DEMI/	4	4	0	4	0	5	1,117,941	5	1,117,941	5	1,117,941	0				0
IV.	TE ARDHURA TE MUNGUARA	1	1	0	1	0	1	1,753,576	1	1,753,576	1	1,753,576	0				0
	(Nga te cilat nuk janë																



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Belsh”

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike								
			Pranuar në numër	Zbatu në numër	Zbatupjesëri sht numër	Pa zbatu në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar pjesërisht/ apo proces zbatimi		Ne Proces Civil apo Penal ne 00/lek	Pazbatuar (Pa fill proced)	
							Nr. Pers/ taks	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë	Nr. pers.	Në 000/lekë		Nr. pers	Në 000/lekë
	kontabilizuar, ne Finance)														
V	Mos efekt/efic/ekon (3-E)	3	3	0	3	0	5	114,377,901	5	114,377,901	5	104,100,906	0	0	
VI	MASA DISIPLINORE	1	1	0	1	0		0					0	0	
	(Nga te cilat nuk janë nxjereurdhrrat,vendimi)	1	1	0	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
VII	MASA ADMINISTRATIVE	0					0	0						0	
	Nga të cilat:	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Gjobat e Inspektoriateve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	(Nga te cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)														
	Gjobat e APP	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	(Nga të cilat nuk janë kontabilizuar ne Financë)														
	Totali	38	38	1	32	5	11	117,380,818	11	117,380,318	11	107,103,823	0	0	